



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 5, datë 28.02.2023**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin shkurt, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.02.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin shkurt.

Siç jeni vënë në dijeni nga sekretarja e këshillit nëpërmjet postës elektronike për rendin e ditës në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe 1 komision i këshillit. Ftoj sekretaren të proçodoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Prezent janë dhe 3 kandidat për anëtarë të Këshillit Bashkiak Durrës: Arbër Elmadhi, Luljeta Metani, Ticjana Verori.

Gjithsej 33 këshilltar në sallë dhe 3 kandidatët.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Kemi 18 pika në rend dite, po kaloj në leximin e tyre.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit të Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK Z. ARBËR IDRIZ ELMADHI
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit të Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK ZJ. LULJETA AGIM METANI
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit të Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK ZJ. TICJANA PETRAQ VERORI
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN SHKURT 2023
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	ËSHTË HEQUR NGA RENDI DITËS
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 315, DATË 18.12.2015 “PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË KLASIFIKIMIT PËR NDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QERA ME STRUKTURË 2+1 DHE 1+1, SEKSIONI II”
7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 248, DATË 10.04.2015 “PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË PËRFITUESVE PËR NDARJEN E

	BANESAVE SOCIALE ME QIRA ME STRUKTURË 2+1 DHE 1+1”, SEKSIONI I, I NDRYSHUAR
8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 474, DATË 23.12.2017 “PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË BANORËVE PËRFITUES TË BANESAVE SOCIALE ME QERA, SEKSIONI III (STRUKTURË 1+1 DHE 2+1), SHKOZET, DURRËS”
9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT TË PASHPENZUARA NË VITIN 2022, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2023
10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 38, DATË 31.03.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR
11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 5, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, RRUGA “5 PRILL” PALLATI NR.15, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, QË DO TË SISTEMOHEN NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM”
12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 118, DATË 27.10.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, RRUGA “DAVID SELENICA”, PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
13.	PËR MIRATIMIN E SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
Pika 14 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 15 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
Pika 15 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.1, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETË E TETË MILION E TREQIND E DYZETË E DYMJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHETITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”, I NDRYSHUAR
Pika 16 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHTATË PARAPRAKE TË 54 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
Pika 17 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 18 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Mandateve znj. Ana Dhamo.

**Ana Dhamo** : Komisioni i Mandateve u mbledh dhe në unanimitet vendosi të kaloj këtë pikë të rendit të ditës për votim në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak. Faleminderit .

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Ftoj të ngrihet në këmbë z. Arbër Elmadhi.

Unë do të lexoj “Formulën e betimit” dhe Ju do të thoni “Betohem”.

*“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*

**Arbër Elmadhi** : Betohem.

**Ani Dyrmishi** : Të ftoj të firmosësh “Formulën e betimit” të cilën e ke përpara. Faleminderit.

Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 2**, ftoj për znj.Luljeta Metani, Kryetaren e Komisionit të Mandateve znj.Ana Dhamo.

**Ana Dhamo** : Edhe për këtë pikë Komisioni Mandateve propozon për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Znj. Metani të ftoj të ngrihesh në këmbë.

Pasi të lexoj “Formulën e betimit” Ju do të thoni fjalën “Betohem”.

*“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*

**Luljeta Metani** : Betohem.

**Ani Dyrmishi:** Të ftoj të firmosësh “Formulën e Betimit” të cilën e keni përpara. Faleminderit. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 3**, ftoj Kryetaren e Komisionit të Mandateve znj. Ana Dhamo.

**Ana Dhamo :** Edhe për këtë pikë Komisioni Mandateve vendosi për ta kaluar në votim në mbledhjen e sotme të Këshillit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Ftoj të ngrihet në këmbë znj. Ticjana Verori.

Pasi të lexoj “Formulën e betimit” Ju do të thoni fjalën “Betohem”.

*“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*

**Ticjana Verori :** Betohem.

**Ani Dyrmishi :** Të ftoj të firmosësh “Formulën e Betimit” të cilën e keni përpara. Faleminderit. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 4**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale mori në shqyrtim pikën 4 të rendit të ditës dhe vendosi përfitues të ndihmës ekonomike për 94 familje me fonde nga të ardhurat e bashkisë dhe përfitues të ndihmës ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar 24 familje, me vota unanime. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet pika 4 e rendit ditës.

- **Pika 5** është hequr nga rendi i ditës .
- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 6**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Përshëndetje!

“Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 315, datë 18.12.2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të klasifikimit për ndarjen e banesave sociale me qera me strukturë 2+1 dhe 1+1, seksioni II””, kemi votuar unanimit për ta kaluar në votim në mbledhjen e sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Budini.

Komente përsa i përket pikës 6, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe kjo pikë ka si qëllim miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 248, datë 10.04.2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të përfituesve për ndarjen e banesave sociale me qira me strukturë 2+1 dhe 1+1”, seksioni I, i ndryshuar. Edhe për këtë pikë komisioni pasi shqyrtoi materialet të vëna në dispozicion nga stafi i bashkisë votuam unanimit për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 8**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe pika 8 është miratimi i ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 474, datë 23.12.2017 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të banorëve përfitues të banesave sociale me qera, seksioni III (strukturë 1+1 dhe 2+1), Shkozet, Durrës”. Edhe për këtë pikë kemi votuar unanimit për ta kaluar sot në mbledhje.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 9**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Mirëdita të gjithëve!

Komisioni ynë vendosi pro miratimit të pikës 9. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 10**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike pasi u mbledh dhe diskutoi vendosi unanimitisht për ta kaluar këtë pikë në mbledhjen e sotme.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Edhe komisioni ynë ka votuar unanimitisht për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi të gjithë relacionin vendosi me vota unanime kalimin në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 10, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.



Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 11**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi për ta kaluar në mbledhjen e sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe komisioni ynë ka votuar unanimisht.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani :** Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës është dakort për kalimin në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 11, komente nga ana e këshilltarëve kemi ?

Komente nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 12**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Edhe për pikën 12 komisioni ynë vendosi për ta kaluar në mbledhjen e ditës sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Unanimisht kemi votuar për kalimin në votim, si komision, sot.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe komisioni ynë pasi shqyrroi relacionin e kësaj pike është dakort për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 12, komente ka nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 12 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 13**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Gjithashtu dhe për pikën 13 komisioni ynë pasi shqyrtoi relacionin vendosi për ta kaluar në votim në mbledhjen e ditës sotme.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Edhe komisioni ynë është pro unanimitet për kalimin e saj.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Gjithashtu komisioni ynë për pikën 13 votoi me vota unanime për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 13, ka nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 13 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 14**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri**: Edhe për pikën 14 komisioni ynë pasi shqyrtoi relacionin vendosi për ta kaluar në rendin e ditës së sotëm.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe komisioni ynë ka votuar pro miratimit të listës së 15 familjeve përfituese për tu kaluar sot në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani :** Edhe komisioni ynë votoi unanimisht për kalimin në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 14, komente nga ana e këshilltarëve kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 14 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 15**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Edhe për pikën 15 gjithashtu vendosëm për ta kaluar në mbledhjen e ditës së sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj. Denisa Luarasi.

**Denisa Luarasi :** Komisioni ynë ra dakort që të kaloj për votim kjo pikë.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 15, komente nga ana e këshilltarëve kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 15 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 16**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Komisioni edhe për pikën 16 vendosi pro për ta kaluar në mbledhjen e ditës së sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe komisioni ynë unanimitisht ka votuar pro kalimit në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani :** Gjithashtu komisioni ynë është pro kalimit në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 16, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 16 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 17**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Edhe për pikën 17 vendosëm për ta kaluar në mbledhjen e ditës së sotme.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe komisioni ynë votoi pro kalimit të kësaj pike.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani :** Gjithashtu komisioni ynë është dakort që të kaloj në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 17, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 17 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 17 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 18**, i japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike z. Fatmir Mërkuri.

**Fatmir Mërkuri:** Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi pro për ta kaluar në mbledhjen e ditës së sotme.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Edhe komisioni ynë pasi shqyrtoi materialet e vëna në dispozicion nga komisionet e bashkisë vendosi me vota pro që të kaloj sot.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar.

Ne si komision pasi pamë materialet e dërguara nga drejtoria përkatëse vumë re për familjen e z.Kujtim Shehu ku është vetëm me 1 (një) bashkëpronar dhe propozojmë të futet dhe bashkëpronari tjetër djali që është Shkëlzeni, pasi nuk është bashkuar dhe çertifikata familjare e Shkëlzenit. Familja ka patur 2+1 dhe është vendosur 1+1, pasi figuron me 1 person. Duke qënë se këto të dy janë bashkëpronar, “Ne” si komision kemi rënë dakort që të futet dhe familja e Shkëlzenit duke qënë se është bashkëpronar dhe nga struktura 1+1 të marrë 2+1, propozojmë “Ne” si komision për ta kaluar.

**Ani Dyrmishi** : Pra , propozoni ndryshimin që të marrë nga 1+1 në 2+1.

**Etleva Velçani** : Po të futet dhe familja Shkëlzenit duke qënë se është bashkëpronar.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë përse i përket pikës 18, komente kemi nga ana e këshilltarëve ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Atëherë kush është pro miratimit të pikës 18 bashkë me ndryshimet përkatëse të propozuara nga Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës?

Kundra?....1

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro dhe 1 kundra miratohet dhe pika 18 dhe e fundit e rendit ditës.

Ka kërkuar fjalën **për diskutim** znj. Flutura Kasa.

**Flutura Kasa** : Faleminderit Kryetar.

Për znj. Kryetare kisha një lutje, për aplikimet për banesat sociale.

Brënda mundësive mund të shtyhet dhe disa ditë për të bërë aplikimet ? Sepse ka shumë vonesa tek vërtetimet e kadastrës dhe te vërtetimet e tatimeve dhe njerëzit nuk arrijnë në kohë për t'i plotësuar dokumentat. Pasi dihet që këto, që aplikojnë janë shtesa në nevojë dhe kanë dhe vështirësi tek aplikimet tek e-albania. Kaq kisha.

**Emiriana Sako** : Ne kemi hapur thirrjen në 27 janar dhe sot është dita e fundit e aplikimeve. Nuk kemi pasur ankesa nga qytetarët përse i takon vonesave të dokumentacionit. Pra nëse kërkesa që Ju ngrini vjen zyrtarisht me shkrim në bashki , “Ne” shqyrtojmë në bazë të legjislacionit. Nëse

kemi hapsirë për të bërë shtyrjen do të marrim vendim pastaj për më të mirën e qytetarëve. Faleminderit.

**Flutura Kasa** : Faleminderit.

**Emiriana Sako** : Gjej rastin të përgëzoj dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu”, studentët e Fakultetit të Shkencave Politike, të cilët kanë zgjedhur të jenë pjesë e këshillit sot për ta pasur si eksperiencë në fushën e tyre studimore.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit Kryetare.

Fjalën për diskutim se ka kërkuar këshilltar tjetër.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbledhja e ardhshme do të njoftohet nga Sekretaria e Këshillit.

Ju faleminderit.

*Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 14(katërmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Proçesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Përfaqësues i Grupit të Pavarur të KB :

FLUTURA KASA